

MITI I HYJNESHËS SË BURIMEVE DHE LUMENJVE NË TRADITËN E BREGDETIT TË JONIT

IRENA GJONI

Universiteti i Tiranës, Filiali i Sarandës, Letërsi shqipe, Sarandë, SHQIPËRIA

Email: gioniirena@yahoo.com

AKTET VI, 4: 438-441, 2013

PËRMBLEDHJE

Kumtesa merret me ndërtimin e mitit të Dafinës në traditën e Bregdetit Jonian. Ngrihet mbi fragmentet që sjellin besimet e legjendat, në të cilët Dafina del në katër funksione: (a) të saktë toponomastik (Përroi i Dafinës dhe Gryka e Panormit); (b) përdorimit të shumtë në kuzhinë (njëra prej erëzave më të përdorshme në ushqime); (c) në praninë në festat kalendarike (një ditë e caktuar e vitit i kushtohet kultit të saj e Diela e Dafinave); dhe (ç) efektet e saj mjekuese (çaji i Dafinës shëron kollën) dëshmojnë për një zhvillim goxha të madh të mitologjisë bregdetare në sferën e florës dhe të faunës. Çështja sheshohet në aspekt krahasimtar me mitet e popujve fqinj, para së gjithash me mitin helen për Dafinën. Nga ballafaqimi i funksioneve të dy mitologjive autorja ka ngritur pikëpamjen se përballë gjerësisë përshkrimore të këtij miti në kulturën mitike helene, miti i Bregdetit Jonian, me thjeshtësinë e vet përmbajtjesore (mangësia e gjerësisë së personazheve, fshehja e shkakut të refuzimit të dashurisë së Apollonit), në dukje sikur del më i varfër, por me fiksimin toponimik, me ditëkultin argumentohet e kundërta: se miti shqiptar është më i vjetër dhe më poetik (fshehja e shkakut lihet të nënkuptohet), përveç tjerash dhe me thjeshtësinë e vet përshkrimore. Kjo nënkupton, gjithashtu, se të shqiptarët e kësaj zone janë bërë përpjekje për ngritjen e saj në hyjni, e cila si bijë e lumit, ku edhe mbyll historinë e vet jetësore fiton atributin e hyjneshtës së lumenjve dhe burimeve. Kumtesa sjell ndihmesë në studimet mitologjike kombëtare dhe njohjen e disa proceseve të mitologjisë ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: mit, mbijetoja, Dafinë, besim, legjendë, toponimi, rekonstruim.

Key words: myth survive, laurel, faith, myth, toponym, reconstruction.

1. Hyrje

Kumtesa merret me ndërtimin e mitit të Dafinës në traditën e Bregdetit Jonian. Ngrihet mbi fragmentet që sjellin besimet e legjendat, në të cilët Dafina del në pesë funksione: (a) të hyjneshtës së lumenjve dhe burimeve, (b) të saktë toponomastik ("Përroi i Dafinës" dhe "Gryka e Panormit"), (c) praninë në festat kalendarike (një ditë e caktuar e vitit i kushtohet kultit të saj "E Diela e Dafinave"), (ç) përdorimit të shumtë në kuzhinë (njëra prej erëzave më të përdorshme në ushqime) dhe (d) efektet e saj mjekuese (çaji i Dafinës shëron kollën). Artefakti mitik për hyjneshtën e lumenjve i këtij studimi të Bregut të Jonit përqaset në aspektin: (a) brendakombëtar dhe (b) jashtëkombëtar – me traditat mitologjike

të popujve fqinjë, ku vendin kryesor e zë tradita e lashtë helene.

Për argumentimin e funksioneve të veçanta e të përbashkëta të mitit të Dafinës në Bregdetin e Jonit, bëhet përafrimi i saj me mitin helen konkretisht për Dhafnin dhe Apolonin. Çështja sheshohet në aspekt krahasimtar. Nga ballafaqimi i funksioneve të dy mitologjive është ngritur pikëpamja se përballë gjerësisë përshkrimore të këtij miti në kulturën mitike helene, miti i Bregdetit Jonian, me thjeshtësinë e vet përmbajtjesore (mangësia e gjerësisë së personazheve, fshehja e shkakut të refuzimit të dashurisë së Apolonit), në dukje sikur del më i varfër, por me fiksimin toponimik, me ditëkultin argumentohet e kundërta se miti shqiptar është

më i vjetër dhe më poetik (fshehja e shkakut lihet të nënkuptohet), përveç tjerash edhe me thjeshtësinë e vet përshkrimore. Kjo nënkupton, gjithashtu, se te shqiptarët e kësaj zone janë bërë përpjekje për ngritjen e saj në hyjni, e cila si bijë e lumit, ku edhe mbyll historinë e vet jetësore fiton atributin e hyjneshës së lumenjve dhe burimeve.

2. Misteri i ujit

Uji si një prej elementeve përbërës të ekzistencës së jetesës në kozmos, në vetvete përmban attribute ambivalente, që dalin nga roli i tij që ka në ritet kozmogonike. Lidhja e kultit të ujërave me Bregdetin e Jonit pasqyrohet edhe në një ndër shpjegimet e emrit të fisit të kaonëve. Sipas studuesve, ky emër është i lidhur edhe me ujërat, përrnjtë. Kaoni - haonoidhi, konike siç është delta e krijuar nga depozitimet e përrnjve. Sot shumë prej përrnjve i emërtojmë **hone** në Bregdetin e Jonit si: Honet e Lukovës, Honet e Brodanit.

Megjithatë as vendi, as klima nuk ishin shumë dorëlëshuar për të pasur burime të shumta ujore dhe të pasura në Kaoni. Lumenjtë mund të shndërrohen në një përrua të vogël, ose të zhduken fare në vapën e verës. Ndaj kjo sillte domosdoshmërinë e të pasurit të një hyu të ujërave.

4. Nuset e ujërave

Imazhi i misterit të ujërave në Bregdetin e Jonit, është krijuar nga Nuset e Ujërave që janë ndër më të përhapurat në këtë trevë. Ato ruanin ujërat e lumenjve dhe të përrnjve të kësaj zone (Gjoni 1988).

Përfytyroheshin si vajza të reja, të bukura, me flokë të gjatë. Paraqiteshin me kurora lulesh, të apasionuara pas lojërave dhe muzikës. Nuset e Ujërave kishin atributet e Najadave, megjithatë ato ndryshojnë përsa i përket origjinës së krijimit. Sipas Homerit, Najadat janë bijat e Zeusit. Mitologë të tjerë thonë se janë bijat e Oqeanit. Ndërsa Nuset e Ujërave mendohet se janë krijuar nga ujërat e lumenjve, ku ato jetojnë (Dhamo 1987: 171). Tek këto Nuse të ujërave mendohet se bën pjesë edhe Dafina. Për këtë arsye merren në shqyrtim dhe analizohen legjenda e besime që

shpjegojnë mënyrën e lindjes e të krijimit të mitit e kultit të ujërave.

3. Ndërtimi i arketipit të mitit të Dafinës

Një nga drurët më të përhapur në zonën e Bregdetit të Jonit, është druri i Dafinës. Përdoret si një ndër erëzat kryesore në gatimet e kësaj zone. Mendohet që ka aftësi kuruese, prandaj përdoret edhe si çaj kundër kollës së mirë. Ekzistojnë disa variante për të shpjeguar mitin e Dafinës, prej nga mendohet se i ka fillesat dhe ekzistenca e këtij druri.

Në këtë zonë qarkullon ky variant: Dafina është bija e perëndisë së lumit. Apoloni e dashuronte, por ajo nuk i përgjigjej dashurisë së tij. Një ditë Apoloni e ndjek. Dafina vrapon për të mos rënë në duart e tij dhe mbërrin deri në grykën e Panormit (Palermos). Përballë shtrihej deti dhe lartësia ishte shumë e madhe. Ndërsa po binte në duart e Apolonit, ajo iu lut Tokës që ta shndërronte në Dafinë. Pikërisht në këtë vend gjenden shumë dafina dhe po në këtë vend derdhet përroi i quajtur “Përroi i Dafinës” (Pali 2003: 37).

Në mitologjinë greke, Dhafni (Dafina) ishte vajza e lumit të Thesalisë, Pinios. Ishte perëndi virgjëreshë e gjahut dhe e natyrës. Historia më e dëgjuar për të, është: “Apoloni e dashuronte Dhafnin pa e dashur ajo. Shkaku kryesor që ajo nuk e donte, ishte se Apoloni kishte fyer Erosin, perëndinë e dashurisë. Apoloni, të cilit i pëlqente të mburrej se sa mirë i përdorte harkun dhe shigjetën, besonte se Erosi ishte shigjetar i keq. Erosi u hakmorr ndaj Apolonit duke e shpuar atë drejt e në zemër me një shigjetë me majë të artë dhe e bëri atë që të dashuronte në mënyrë të dëshpërueshme Dhafnën. Erosi e qëlloi dhe Dhafnën, por tek ajo shigjeta kishte majë prej plumbi, e cila e bëri akoma më kundërshtuese ndaj dashurisë së Apolonit (Connor 1988: 155 – 189).

Ai, totalisht i çmendur, filloi ta ndiqte të dashurën e tij duke i thënë: “Të lutem nimfë, vajza e Pinios, mos ik larg! Megjithëse unë të ndjek, nuk jam armik. Qëndro nimfë e ëmbël! Po largohesh ashtu siç po largohet qengji nga ujku, ose dreri nga luani, ashtu si pëllumbat fluturojnë të

shqetësuar larg nga një shqiponjë, si të gjitha gjallesat largohen nga armiku i tyre. Por dashuria ime e madhe më detyron të të ndjek pas” (Ovidi 1992).

Dhafni nuk mund të ikte dot nga Apoloni. Në fund iu lut në mënyrë të dëshpëruar të atit të saj, që ta çlirojë nga trupi që kishte ndezur pathosin e Apolonit. Ai e shndërroi në pemën e Dhafnës (Dafinës) që u bë druri i shenjtë i Apolonit” (Houtzager 2004: 91).

Një variant tjetër e tregon Dhafnën pjesë të shpurës së vajzave të Artemisë, që ashtu si zonja e tyre, kanë hequr dorë nga çdo kontakt nga burrat, çka zgjon jo vetëm interesin e një njeriu, pasi janë të shumtë ata që duhet ta kalojnë jetën duke vuajtur një gabim të tillë. Njëri prej tyre është i vdekshmi Leukip. Për t’iu afruar së dashurës, ai vishet si grua. Apoloni xheloz, i propozon Dhafnës dhe shoqërueseve të saj që të zhvishen dhe të shkojnë të lahen. Fatkeqi duhet të bëjë të njëjtën gjë dhe nimfat përgatiten ta vrasin, por edhe fati i Apolonit nuk shkon më tej. Atëherë kur nimfa e re nuk pranon asnjë afrim, hyjniu përpiket të përdorë forcën. Në çastin kur ai po e shtrëngonte fort, Dhafna thirri Tokën dhe kjo menjëherë e shndërroi nimfën në dafinë (Dommernuth – Gudrich 2006: 52): “Me të mbaruar lutjen, gjymtyrët e saj pushtohen nga një topitje e rëndë. Një lëkurë e hollë rrethon gjirin e saj të brishtë. Flokët e saj që zgjaten, u shndërruan në gjethe, krahët e saj në degë. Këmbët e saj, aq të shkathëta para pak çastesh, hynë në tokë përmes rrënjëve të pazonja për të lëvizur. Maja e një druri kurorëzon kokën e saj. Nga bukuria e saj mbeti vetëm shkëlqimi.” Kështu e përshkruan këtë shndërrim poeti latin Ovidi tek *Metamorfozat* (Ovidi 1992).

Në lashtësi Dafina ishte druri i Apolonit. Me gjethet e saj kurorëzoheshin ata që ndiqnin shembullin e tij: fitimtarët e olimpiadave, heronjtë ngadhënjimtarë dhe poetët e famshëm. Pitia e Delfit, që parathoshte të ardhmen, përtypte gjethe dafine për ta pushtuar drithërimat (Dommernuth – Gudrich 2006: 52).

5. Epërsia e variantit shqiptar

Thelbi i mitit, si histori e treguar, është i njëjtë si në zonën e Bregdetit të Jonit, ashtu dhe në atë grek. Megjithatë, varianti në zonën e Bregdetit të Jonit, është më i thjeshtësuar dhe me më pak “personazhe”. Thuhet që Dafina (edhe emri ka ndryshim nga emërtimi grek Dhafna) është bijë e perëndisë së lumit, po nuk përcaktohet emri i kësaj perëndie. Apoloni e dashuronte, por ajo nuk i përgjigjej dashurisë së tij.

Në mitin e Bregdetit të Jonit nuk jepet shkaku i refuzimit të dashurisë prej saj, ashtu siç ndodh tek dy variantet e mësipërme. Dafina vrapon për të mos rënë në duart e Apolonit dhe mbërrin deri në grykën e Panormit (Palermos).

Siç e vëmë re, miti bregdetas ka një vend të përcaktuar se ku ndodh metamorfizimi i Dafinës, gjë që nuk ndodh te miti grek. Madje, këtu derdhet përroi i quajtur “Përroi i Dafinës”. Pra, prej emrit të saj kemi një hidronim (emërtim përroi) që përsëri nuk e kemi hasur askund në mitologjinë greke (as hidronim, as toponim).

Të gjitha këto tregojnë se miti bregdetas është më i qëndrueshëm, se lidhet direkt me ekzistencën e një përroi. Kjo qëndrueshmëri theksohet akoma më tepër dhe me një festë pagane të quajtur “E Diela e Dafinave” që festohet në Bregdetin Jonian. Kjo festë shërben si pikënisje e festës tjetër pagane “E Diela e Luleve”. Mandej, me krishtërimin është bërë pikënisja e Shën L Lazarit, që festohet një javë para Pashkës së Madhe (Tirta 2004: 365).

Sipas mendimit tim, një shkak tjetër i epërsisë që ka miti bregdetas i Dafinës mbi atë të Dhafnit është i lidhur dhe me ndryshimet vendore, ku gjendeshin këto mite. Disa prej miteve që adhuroheshin në mënyrë entuziaste në Bregdetin e Jonit, quheshin të parëndësishëm në Greqi, apo dhe e kundërta. Shembulli më tipik i këtij rasti është miti i Dafinës.

Përmes analizës dhe interpretimit të mitit në kultin e botës bimore të Dafinës, në Bregdetin e Jonit përfitohet njohuria e mënyrës së ngritjes e të funksionimit të mitit për të. Ngritja në kult e bimës së dafinës dhe përhapja e saj shumë e madhe në krahinën e Bregdetit Jonian, janë një

argument tjetër për pasurinë e madhe të botës mitologjike shqiptare të kësaj zone.

6. Përfundim

Si përfundim, besimet e legjendat, përfaqësimi kaq i madh i Dafinës në Bregdetin Jonian të para në funksion (a) të hyjneshës së lumenjve dhe burimeve, (b) të saktë toponomastik (“Përroi i Dafinës” dhe “Gryka e Panormit”), (c) praninë në festat kalendarike (një ditë e caktuar e vitit i kushtohet kultit të saj “E Diela e Dafinave”), (ç) përdorimit të shumtë në kuzhinë (njëra prej erëzave më të përdorshme në ushqime) dhe (d) efektet e saj mjekuese (çaji i Dafinës shëron kollën) dëshmojnë për një zhvillim të madh të mitologjisë bregdetare. Përballë gjerësisë përshkrimore të këtij miti në kulturën mitike helene, miti i Bregdetit të Jonit, me thjeshtësinë e vet përmbajtjesore (mangësia e gjerësisë së personazheve, fshehja e shkakut të refuzimit të dashurisë së Apolonit), në dukje sikur del më e varfër, por me fiksimin toponomastik, me ditëkultin argumentohet e kundërta se miti shqiptar është më i vjetër dhe më poetik (fshehja e shkakut lihet të nënkuptohet), përveç tjerash edhe me thjeshtësinë e vet përshkrimore. Kjo nënkupton, gjithashtu, se te shqiptarët e kësaj

zone janë bërë përpjekje për ngritjen e saj në hyjni, e cila si bijë e lumit, ku edhe mbyll historinë e vet jetësore, fiton atributin e hyjneshës së lumenjve dhe burimeve. Përmes ndërtimit të arketipit të Dafinës në Bregdetin e Jonit shqiptar, është bërë përpjekje për të sjellë një ndihmesë në studimet mitologjike kombëtare dhe njohjen e disa proceseve të mitologjisë ndërkombëtare.

Bibliografi

- ARKIVI vetjak i familjes Gjoni
 CONNOR, W. R. (1988), *Seized by the nymphs; Nympholepsy and symbolic Expression in Classical Greece: Classical Antiquity 7*.
 DHAMO, Todi (1987), *Fjalori i mitologjisë*, Tiranë.
 DOMMERNUTH-GUDRICH, Gerold (2006), *Mitet*, Tiranë.
 GJONI, Minella (1988), *Mite dhe rite të Bregdetit të Poshtëm*, Dorëshkrim.
 HOUTZAGER, Guus (2004), *Ελληνική Μυθολογία*, Athinë.
 OVIDI (1992), *Metamorfozat*, vëll. I.
 PALI, Janko (2003), *Historia e Qeparoit*.
 TIRTA, Mark (2004), *Mite e besime në Bregdetin e Sipërm të Himarës: Himara në shekuj*.